



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.758/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me apelin e Besnik Hajrizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara apelet e parashtruara nga Besnik Hajrizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), meshenjën ZL.Anr.758/2017, ZL.Anr.759/2017, ZL.Anr.760/2017, ZL.Anr.761/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar apelet e parashtruara nga Besnik Hajrizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik, (LDK), me shenjën ZL.Anr.758/2017, ZL.Anr.759/2017, ZL.Anr.760/2017, ZL.Anr.761/2017, të datës 09.11.2017. Në apelet e parashtruara nga apeliuesi pretendohen se në Qendrat e Votimit: 1330E, QV 1323e, QV 1328e, dhe QV1322e, i mungojnë votat e tij.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.758/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për shtatë apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apele si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli i PZAP-it, pas vlerësimit të pretendimeve në apele gjeti se me asnjë provë bindëse nuk janë dëshmuar pretendimet në apele dhe nuk i ka specifikuar se sa vota dyshon që i mungojnë për qendrat e votimit me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të votave. Prandaj, Paneli apelet i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apele, konstaton se apelet në fjalë janë të pabazuara dhe e të pa argumentuara dhe si të tilla apelet i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.758/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*